



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
TREGËTISË DHE ENERGJITIKËS

Plani i Integruar i Ministrisë 2010

2010

Mesazhi i Ministrit

Plani i Integruar i Ministrisë (PIM) për vitin 2010 përfaqëson dokumentin e katërt të radhës të prezantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. PIM 2010 është hartuar mbi bazën e eksperiencës së krijuar nga programet e mëparshme. Programi prezanton në mënyrë të konsoliduar objektivat dhe programet e Ministrisë të bazuara në një kuadër afatgjatë planifikimi siç është Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, strategjitë sektoriale dhe PBA 2010 - 2012. Dokumenti prezanton të gjitha proceset dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2010, përfshirë detyrimet e METE në kuadër proceseve të integritit Europian.

Viti 2009 shënon kurorëzimin e një pune intensive të kryer në vitet e kaluara. Gjatë këtij viti u arrit nënshkrimi i kontratës për shitjen e 76 përqind të aksioneve të shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes", e miratuar nga Këshilli i Ministrave, si edhe nga Kuvendi me ligjin Nr. 10 116, datë 23.4.2009. Gjatë vitit 2009 është punuar intensivisht për përfundimin e procedurave për shitjen e paketës së mbetur të aksioneve të shoqërisë ARMO sh.a., dhe është arritur nënshkrimi i marreveshjes për shitjen e aksioneve të mbetura shtetërore në shoqërinë AMC, e cila tashmë është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 308, datë 25.03.2009.

Gjatë vitit 2009 është realizuar nënshkrimi i rreth 56 kontratave koncesinare për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve të vegjël nga investitorë vendas dhe të huaj. Janë nënshkruar kontratat e ndërtimit të kasakades së hidrocentraleve mbi lumin Devoll dhe mbi lumin e Shalës(). Në fushën e industrisë nxjerrëse dhe minerare janë licensuar 132 subjekte të reja minerare me një volum investimesh prej rreth 18,3 milion Euro, janë shpallur edhe tre zona ekonomike, ku dy kanë statusin e parqeve industriale dhe një statusin e zones së lire.

Në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit ekonomik dhe të terheqjes së investimeve të huaja janë negociuar dhe nënshkruar një numër marrëveshesh në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe të nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve. Është bërë tërësisht funksionale Qendra Kombëtare e Licensimit, duke thjeshtuar ndjeshëm procedurat e licensimit. QKL tashmë ofron shërbime të shpejta dhe transparente për bizneset e interesuara për marrjen e një license apo leje. Koha dhe kosto për regjistrimin e një biznesi është reduktuar ndjeshëm: tashmë bizneset e reja mund të regjistrohen brenda një ditë dhe me një kosto simbolike prej një Euro. Në fushën e legjislacionit është miratuar Ligji nr. 10128, datë 11.05.2009 "Për Tregtinë Elektronike", si dhe janë ndermarrë hapa të mëtejshëm për kompletimin e kuadrit ligjor në fushën e akreditimit, standarteve dhe metrollogjisë, mbrojtjes së konsumatorit, pronësisë industriale, etj.

Për sa i takon strukturës së programeve, PIM 2010 është në vazhdimësi të Planit të Integruar të vitit 2009. Për vitin 2010 METE prezantohet me të njëjtin numër programesh, të cilët janë hartuar në mbështetje të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale dhe planeve të veprimit dhe kanë një vizion të qartë dhe lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat e Ministrisë për vitin 2010.

Në aspektin e përmbajtjes, PIM 2010 prezanton tërësinë e angazhimeve vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zhvillimin e sektorit energjetik, për zhvillimin e mëtejshëm të një tregu kompetitiv të bazuar në konkurrencën e lirë dhe mosdiskriminimin, të masave për përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit dhe promovimin e investimeve vendase dhe të huaja. Në këtë kontekst, viti 2010 do të

shënojë një hap tjetër në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të imazhit të Shqipërisë si një vend atraktiv si për biznesin vendas ashtu dhe për biznesin e huaj.

Në fushën e privatizimit, me synim privatizimin e plote të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) do të përgatiten urdhërat perkatës dhe do të fillohen procedurat për privatizimin e pjesës së mbetur të aksioneve për punonjësit dhe pronaret; do të vazhdojnë procedurat për privatizimin e paketës së mbetur të aksioneve të shoqërisë ARMO sh.a; do të realizohet privatizimi i plotë i paketës shtetërore në shoqërinë Albtelekom.

Paralelisht do të vazhdojë puna për nxitjen dhe zgjerimin e politikave dhe programeve të bashkëpunimit dhe partneritetit me sektorin privat, sidomos në promovimin dhe zgjerimin e skemës së ndërtimit të burimeve të reja energjetike.

Në sektorin energjetik, tashmë METE ka një kuadër ligjor të kompletuar dhe një kuadër politikash afatgjata për zhvillimin perspektiv të këtij sektori. Gjatë vitit 2010 do të punohet për një perqasje të metejshme të kuadrit ligjor me *acquis communautaire* dhe përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës energjetike. Do të perfundojë puna për ndërtimin e linjës 400 kV të interkoneksionit Elbasan - Podgorice dhe do të fillojë puna për ndërtimin e linjes së transmetimit Shqipëri - Kosove që do të rrisë dhe përmirësojë më tej kapacitetet e shkëmbimit të energjisë, hapjen e tregut dhe integrimin e mëtejshëm të sistemit elektro-energjetik shqiptar në sistemin rajonal të energjisë. Për vitin 2010 do të vazhdojë të konsiderohet me përparësi rritja e eficiencës së shfrytëzimit të burimeve energjetike të vendit dhe përdorimi sa më ekonomik dhe me ndikim sa më minimal në mjedis i produkteve energjetike. Përparësi do të jetë nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë (HEC-et e vegjël, energjia e erës dhe ajo diellore), dhe shfrytëzimi sa më eficient i burimeve lokale të energjisë.

Gjatë vitit 2010, METE, në kuadër të përpjekjeve për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit privat, do të hedhë hapa konkrete për zbatimin e programit për mbështetjen e SME-ve për rritjen e konkurrueshmërisë nëpërmjet transferimit të teknologjise dhe novacionit 2010-2012. Po kështu gjatë vitit 2010, në kuadër të reformës rregullatore, do të mundësohet fuqizimi i metejshëm i Qendrës Kombëtare të Licensimit. Do të punohet gjithashtu për vënien në funksionim të zonave ekonomike të miratuara. Gjatë vitit 2010 do të intensifikohet bashkëpunimi bilateral ekonomik dhe tregtar do të zgjerohet më tej, si në planin rajonal ashtu dhe atë ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2010 do të mundësohet përgatitja e një dokumenti të plotë për zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal (Policy Paper), do të mundësohet hartimi i kuadrit ligjor për zhvillimin rajonal si dhe rishikimi i infrastrukturës institucionale për menaxhimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal të percaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal. Përparësi do të jetë hartimi dhe miratimi i ligjit "Për zhvillimin rajonal në Republikën e Shqipërisë" dhe ngritja e institucioneve në nivel qendror dhe rajonal, përfshirë ngritjen në METE të një drejtorie për zhvillimin e integruar rajonal.

Psqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	5
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	6
3	Programet buxhetore të Ministrisë	9
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010.....	10
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë	15
Aneks 1	Programi i pergjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2010	16
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	17
Aneks 3	Investimet publike	22
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	24
Aneks 5	Plani i veprimit antikorrupsion për vitin 2010	25

1 Misioni i Ministrisë

Harton dhe zbaton politika që nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, mundësojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe perspektiv të burimeve energjetike të vendit, mundësojnë administrimin me efikasitet të pronës publike dhe privatizimin e saj, përmirësojnë klimën e biznesit dhe nxisin tërheqjen e investimeve të huaja, mundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe krijimin e një tregu të sigurtë dhe të hapur ndaj konkurrencës, e që nxisin e zhvillojnë bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar.

2 Dokumentat Strategjike të Ministrisë

Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2007 - 2013

Strategjia ka si qëllim të mbështesë objektivin e qeverisë për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes zhvillimit të sipërmarrjes, përmirësimit të klimës së biznesit dhe investimeve, aplikimit të politikave nxitëse për eksportet, shfrytëzimit më të mirë të burimeve financiare e natyrore të vendit, rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së biznesit si dhe krijimit të një partneriteti afatgjatë dhe të qëndrueshëm shtet-biznes.

Strategjia ka një plan të detajuar financiar, në të cilin janë inkluduar edhe kostot që gjenerohen në zbatim të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve është miratuar me VKM Nr.795, datë 11.07.2007.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2009 - 2020

Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton drejtimet kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm dhe perspektiv të sistemit energjetik, për krijimin e një sistemi eficient dhe të bazuar në parimet e tregut, të një sistemi që garanton sigurinë e furnizimit dhe plotësimin me kosto minimale të kërkeses për energji dhe që merr në konsideratë edhe mbrojtjen e mjedisit.

Strategjia parashikon një hapje efektive të tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe një pjesëmarrje aktive në tregun rajonal në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të vendeve të Evropës Juglindore, si dhe të kërkesave të Bashkimit Evropian për reformimin e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2007 - 2013

Dokumenti i Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut, e miratuar me VKM Nr. 797, datë 14.11.2007, është përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) dhe Ministrinë e Shëndetësisë (MSH).

Strategjia do të konsolidojë bazën institucionale të mbikëqyrjes së tregut, për produktet industriale dhe ushqimore, si edhe arritjen e një mbrojtjeje efikase të konsumatorëve. Në zbatim të kësaj strategjie, Shqipëria synon të arrijë një kuadër ligjor të harmonizuar me atë të Bashkimit Evropian; kapacitete të nevojshme administrative për zbatimin e ligjit; dhe mbrojtjen efektive të konsumatorit shqiptar nga risqet dhe kërcënimet me të cilat ai përballet, dhe të cilat ai nuk mund t'i trajtojë në mënyre individuale.

Strategjia sektoriale për Infrastrukturën e Cilësisë

Strategjia e Infrastrukturës së Cilësisë është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.272, datë 05.03.2008. Strategjia shënon hapin e parë drejt harmonizimit të politikave dhe objektivave të institucioneve të Infrastrukturës së Cilësisë, që ka një rol parësor jo vetëm në garantimin e sigurisë së produkteve por edhe në eliminimin e barrierave teknike në tregti duke nxitur eksportet dhe rritur shkëmbimin e mallrave.

Kjo strategji është mbështetur në një vlerësim real të gjendjes aktuale të Infrastrukturës së Cilësisë në Shqipëri, mbi bazën e së cilës janë përcaktuar objektivat

afat-mesme të zhvillimit. Duhet theksuar që termi “afat-mesëm” për vetë problematikën që bartin institucionet e Infrastrukturës së Cilësisë në aspektin e investimeve, është përcaktuar 15 vjet për zhvillimin e metrologjisë, 10 vjet për akreditimin dhe 5 vjet për standardizimin.

Strategjia është në përputhje me të gjitha praktikatat e BE -së në këtë fushë, Dokumentin e Partneritetit Evropian 2007, MSA si dhe PKZMSA. Zbatimi i kësaj strategjie do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e integritit evropian, garanton sigurinë e produkteve të vendosura në tregun shqiptar, ndihmon në eliminimin e barrierave teknike në tregti, duke sjellë rritjen e vëllimit të shkëmbimeve tregtare si dhe në rritjen e aftësisë konkurruese të kompanive shqiptare.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal 2007 - 2013

Strategjia përcakton politikatat bazë për mundësimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të balancuar social-ekonomik të të gjithë rajoneve të vendit. Strategjia synon me përparësi ndërtimin e një kuadri ligjor dhe institucional të unifikuar për zhvillimin rajonal, i cili do të jetë i koordinuar në të tre nivelet e qeverisjes dhe që do të shërbejë si bazë për menaxhimin e politikave të zhvillimit rajonal. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj strategjie është edhe tërheqja dhe integrimi i zonave të pafavorizuara të vendit në proceset e zhvillimit.

SNZHR do të mbështesë një politikë të zhvillimit të rajoneve të vendit të integruar me politikatat sektoriale të Qeverisë duke nxitur rritjen e kapaciteteve të zhvillimit të Autoriteteve Vendim-marrës të rajoneve për të përdorur dhe menaxhuar potencialet e tyre të zhvillimit dhe për të përmirësuar thithjen e fondeve publike nëpërmjet një koordinimi më të mirë dhe integritit të ndërhyrjeve për zhvillim dhe shërbimeve në nivel rajonal dhe lokal.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal është përgatitur nga METE në bashkëpunim me 9 ministri të tjera dhe është asistuar nga PNUD. Dokumenti i plotë i strategjisë është miratuar me VKM nr. 773, datë 14.11.2007 së bashku me planin e veprimit për periudhën 2008 - 2009.

Qëllimet

Politikat e Ministrisë janë hartuar me synim arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi i eficiencës së shfrytëzimit të ndërmarrjeve të sektorit publik nëpërmjet ristrukturimit dhe privatizimit të shoqërive shtetërore në sektorët strategjike të energjisë elektrike dhe të naftës, përfshirë edhe privatizimin e shoqërive me kapital shtetëror dhe aseteve të sektorëve jo-strategjik (SME-ve).
- Forcimi i partneritetit publik-privat dhe nxitja e investimeve koncesionare në sektorin energjetik dhe industrial.
- Nxitja e një shfrytëzimi sa më eficient të burimeve energjetike të vendit si dhe të përdorimit sa më ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis të produkteve energjetike, në funksion të objektivave për një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.
- Rritja e sigurisë së furnizimit me burime energjetike nëpërmjet diversifikimit të sistemit energjetik dhe ndërtimit të veprave të reja gjeneruese dhe linjave të interkonjeksionit, nxitjes së përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë

(HEC-eve te vegjël, energjise se erës, asaj diellore e biomasës), për të bërë të mundur shfrytëzimin në maksimum të burimeve lokale.

- Hapja e tregut të brendshëm të energjisë dhe integrimi i tij në tregun rajonal të energjisë, në përputhje me objektivat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Vendeve të Evropës Juglindore, si dhe te zbatimit të kërkesave të Bashkimit Evropian për reformimin e sektorit elektroenergjetik (Direktiva 54/2003 e BE-se).
- Sigurimi i një rritje të qëndrueshme ekonomike përmes rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së biznesit, krijimit të vendeve të reja të punës, përmirësimit të ambientit rregullator, reduktimit të informalitetit në ekonomi, nxitjes së prodhimeve për eksport, thithjes së investimeve të huaja, krijimit të zonave ekonomike.
- Krijimi i një sistemi të vetëm planifikimi dhe menaxhimi për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri, të koordinuar në të tri nivelet e Qeverisjes, që do të rrisë aftësitë dhe kapacitetet e të gjithë Autoriteteve Vendim-marrëse të Rajoneve për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrueshmërinë në të gjithë vendin duke reduktuar pabarazitë e zhvillimit socio-ekonomik ndërmjet tyre.
- Krijimi i kushteve për lëvizjen e lire të mallrave si dhe sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe interesave ekonomike të konsumatorëve si dhe mbrojtjen e të drejtave të pronarëve të objekteve të pronësisë industriale.
- Zhvillimi i industrisë minerare në Shqipëri dhe përgatitja e politikave të zhvillimit dhe integritit të aktivitetit minerar në ekonomi në shkallë vendi për vlerësimin e potencialit mineral-mbajtës të vendit tonë dhe futjen në qarkullim me efektivitet ekonomik të grup mineraleve tradicionale, atyre të rinj, si edhe promovimin e tyre.
- Promovimi dhe shfrytëzimi racional i burimeve natyrore, mirëadministrimi i territorit dhe gjeomjedisit në shërbim të komunitetit.
- Forcimi i kapaciteteve të planifikimit afatgjatë për një menaxhim sa më efektiv të politikave dhe programeve sektoriale si dhe të burimeve financiare për zbatimin e tyre.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në planifikimin, menaxhimin dhe administrimin e burimeve financiare, njerëzore dhe materiale të ministrisë; koordinimin dhe monitorimin e programeve të METE, bazuar në PIM, SKZHI, PBA dhe Programin e Qeverisë.

3.2 MBËSHTETJE PËR ENERGJINË

Politika e këtij programi konsiston në: zhvillimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e sektorit të energjisë dhe të tregut të energjisë, në zbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian; garantimin e një furnizimi të sigurt të ekonomisë me burime energjetike dhe diversifikimin e burimeve të furnizimit me produkte energjetike, për të siguruar një zhvillim të shpejte dhe të qëndrueshëm ekonomik e social të vendit, si dhe për integrimin e vendit në BE; mbrojtjen e mjedisit në sektorin energjetik dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore tokësore dhe nëntokësore.

Një rëndësi e vecantë do të tregohet për regjimin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre, si dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme për nxitjen e zhvillimit të tregut të gazit natyror.

3.3 MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE

Politika e programit konsiston në zbatimin e politikave nxitëse, promovuese efektive për ristrukturimin e kapitalit mineral, zhvillimin e investimeve vendase e të huaja në sektorin mineral, mirëadministrim të pasurive natyrore në drejtim të shfrytëzimit racional të tyre, mirëadministrimin e territorit dhe gjeomjedisit në shërbim të komunitetit dhe nëdobi të vendim marrjes e planifikimit të territorit, në nivel lokal dhe qendror, politika transparente në përputhje me objektivat strategjike kombetare të zhvillimit dhe ata sektoriale të afta të përballojnë sfidat e sektorit mineral.

3.4 MBËSHTETJE PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Politika e këtij programi konsiston në hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit privat përmes reduktimit të barrierave të biznesit, thjeshtimit dhe standartizimit të tyre në përputhje me praktikën ndërkombëtare, nxitjes së investimeve të huaja, eksportit të mallrave dhe shërbimeve, nxitjes së zhvillimit të infrastrukturave me teknologji të lartë, hartimit të platformave dhe programeve për ristrukturimin dhe privatizimin e shoqërive tregtare dhe zhvillimit të zonave ekonomike.

3.5 MBËSHTETJE PËR MBIQYRJEN E TREGUT, INFRASTRUKTURËN E CILËSISË DHE PRONËSISË INDUSTRIALE

Politika e këtij programi konsiston në konsolidimin e kushteve për lëvizjen e lire të mallrave, sigurimin e një niveli më të lartë të mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe interesave ekonomike të konsumatorëve dhe mbrojtjen e pronësisë industriale.

3.6 MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e qëndrueshëm të të gjithë rajoneve të vendit duke reduktuar diferencat e zhvillimit ndërmjet tyre dhe shmangur shkaqet e krijimit të disballancave të reja.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2010.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Rritja e eficiencës së përdorimit të burimeve financiare, njerëzore e materiale të ministrisë me synim arritjen e objektivave të ministrisë në kuadër të programeve dhe strategjive sektoriale të përfshira në SKZHI.
- Përgatitja e programeve afatshkurtra dhe afatmesme të buxhetit, përgatitja e dokumentave strategjike për ndihmen e huaj dhe prioritetet afatmesme të ministrisë, të planeve të integruara të ministrisë (PIM), përgatitja dhe administrimi i kuadrit rregullator për bashkëpunimin bilateral ekonomik dhe tregtar dhe mbrojtjen reciproke të investimeve. Azhornimi i politikave, programeve dhe strategjive në mbështetje të politikave të Qeverisë për zhvillimin ekonomik.
- Monitorimi dhe vlerësimi i politikave dhe programeve sektoriale me synim përmirësimin e cilësisë së planifikimit dhe të menaxhimit të burimeve, azhornimi i politikave dhe programeve me qëllim përmbushjen e misionit të ministrisë.
- Zbatimi i planit kombëtar të zbatimit të MSA në terma afat-shkurtër.

Produktet që do të ofrohen:

- Programi vjetor dhe afatmesëm i buxhetit për periudhën 2011 - 2013;
- Plani i Integruar i Ministrisë; Dokumenti për Politikën Prioritare afatmesme të Ministrisë; Raporti Monitorimit të Projekteve me Financim të Huaj; Programi i integruar i Ministrisë, raportet për monitorimin e strategjive sektoriale, si dhe kontributet për hatimin e dokumentave të tjerë strategjike të përgatitura nga institucione të tjera.
- Marrëveshjet për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregtar Bilateral, Marrëveshjet për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve; Marrëveshjet institucionale bilaterale, Memorandume bashkëpunimi, Botime.
- Raporti vjetor për zbatimin e MSA-së, raportet mujore në kuadër të zbatimit të PKZMS

4.2 MBËSHTETJE PËR ENERGJINË

Objektivat e politikës

- Fillimi i procedurave për paketën e mbetur të aksioneve shtetërore për shoqërinë Armo sha.
- Fillimi i procedurave për paketën e mbetur të aksioneve shtetërore për shoqërinë OSSH sha.
- Konsolidimi i kuadrit ligjor për funksionimin sa më efikas të sektorit të energjisë
- Dhënia me koncesion e hidrocentraleve, veçanërisht e hidrocentraleve të Skavicës dhe të lumit të Vjoses.
- Përgatitja e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator, në përputhje me direktivat e BE-së për nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike.

- Përgatitja e kuadrit ligjor, në përputhje me direktivat e BE-së për eficientësinë e energjisë.
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë elektrike dhe përmirësimi i strukturës së prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve të reja termike.
- Nenshkrimi i Marrëveshjeve Financiare të tjera me Donatorët, për realizimin e plotë të Projektit të Sigurisë së Digave.
- Rritja e mundësive për thithjen e investimeve strategjike në sektorin hidrokarbur.
- Diversifikimi i burimeve të furnizimit me burime energjetike hidrokarbure.
- Garantimi i një furnizimi të sigurt të vendit me burime energjetike hidrokarbure.
- Rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional për regjimin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë për naftën gazin dhe nënproduktet e tyre.
- Nxitja dhe mbështetja e oportuniteteve për realizimin e lidhjes së Shqipërisë me rrjetet rajonale të naftës dhe gazit të sjellësave.
- Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator për zhvillimin e tregut të gazit natyror.
- Rritja e eficientësisë së energjisë nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse alternative.
- Informimi i të gjithë aktorëve dhe faktorëve në tregun e burimeve energjetike hidrokarbure me të dhënat e sektorit për vitin 2009 dhe parashikimi i trendeve të zhvillimit të tij për të ardhmen e afërt.

Produktet që do të ofrohen

- Paketat e llogaritura të aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe punonjësit e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- Paketat e llogaritura të aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe punonjësit e ARMO sha.
- Akte ligjore dhe nënligjore për miratimin dhe zbatimin e këtyre objektivave për sektorin e energjisë.
- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2010-2025, të përditësuar;
- Projekt ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike;
- Bilanci Energjetik vjetor për vitin 2009;
- Kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator për burimet e rinovueshme;
- Kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator për eficientësinë e energjisë;
- Rritja e numrit të hidrocentraleve të dhëna me konçension;
- Përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore rregullator dhe teknike në zbatim të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.
- Përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore rregullator dhe teknike në zbatim të ligjit nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”.
- Rritja e prodhimit të naftës bruto në masën deri në 10%;
- Realizimi i kërkesave të Marrëveshjeve Hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve

- Rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbajtjen e menaxhimin e rezervës së sigurisë, referuar edhe direktivave të BE;
- Përgatitja e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”.
- Përgatitja e buletinit informativ, ekonomik dhe shkencor për aktivitetin e sektorit energjetik hidrokarbur për vitin 2009.

4.3 MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE

Objektivat e politikës

- Mbikqyrja e Shfrytëzimit Efektiv të Pasurive Minerale.
- Monitorimi i Fenomeneve Post Shfrytëzimit dhe uzinave metalurgjike
- Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkime teknologjike dhe mjedisi
- Perpunimi i direktivave të BE
- Dixjitalizimi i të dhënave të industrisë minerare
- Vazhdimi i mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe jo efektive, privatizimi i aseteve
- Konservimi dhe privatizimi i aseteve të industrisë prodhuese
- Ndertimi i landfillit të Uzinës së Sodë-PVC Vlorë
- Monitorimi i ujrave Nëntokësore
- Rivlerësimi i pasurive natyrore dhe vënia e tyre në efikasitet
- Administrimi i territorit, Gjeologjia-Territori-Mjedisi
- Studime komplekse në fushën e gjeomjedisit. Monitorimi i tij
- Rreziku gjeologjik dhe Infrastruktura publike
- Studime e projektim për nevoja emergjente.

Produktet që do të ofrohen

- Raport vjetor mbi rezultatet e monitorimit për çdo basen;
- Raport studimor i rivlerësimit gjeologjik ekonomik;
- Ndërtim i hartave shumëqëllimore të shkallës 1:25000.
- Raport vjetor mbi rezultatet e arritura;
- Raport studimor për tematikat e rrezikut gjeologjik në shkallë vendi;
- Relacionet studimore me përfundimet përkatëse dhe sipas rastit me projektimin e shpimeve për ujë;
- Raporte për shfrytëzimin e rezervave minerare nga subjektet private të licencuara;

- Databaze i plotë me të dhënat e industrisë minerare

4.4 MBËSHTETJE PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Objektivat e politikës:

- Thellimi i Reformës Rregullatore nëpërmjet zbatimit të reformës në sistemin e inspektimit, si dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të Reformës Rregullatore, si një proces i vazhdueshëm dhe i pandalshëm.
- Skema për mbështetjen financiare për rritjen e konkurrueshmërisë së kompanive.
- Zgjerimi i linjave të kreditimit të SME-ve.
- Perfundimi i shitjes së aksioneve shtetërore të shoqërisë Albtelecom sha.
- Ngritja e kapaciteteve administrative, e parë në kuadrin e veprimeve të përbashkëta dhe të harmonizuara në hartimin e politikave tregtare.

Produktet që do të ofrohen:

- Përgatitja e bazës ligjore dhe infrastrukturës fizike për parqet industriale;
- Implementimi i skemës së kreditimit tëSME-ve nga programi Italian , transhi i dytë prej 10 Mln.Euro;
- Vazhdim i skemës së Fondit të konkurrueshmërisë në vlerë prej 35 Mln.Lekë
- Hartimi dhe miratimi i kontratave koncesionare për ndërtimin e infrastrukturës fizike për parqet industriale;
- Hartimi i strategjisë së inovacionit dhe transferimit të teknologjisë per biznesin;
- Krijimi i Qendrës së biznesit për teknologjinë dhe Inovacionin;
- Hartimi i kuadrit ligjor për zhvillimin e inovacionit.
- Hartimi i kuadrit ligjor për reformën në inspektim në përputhje edhe me direktivat e BE-së.
- Përgatitja e kuadrit ligjor për ngritjen e sistemit RIA, mbështetur në praktikat ndërkombëtare, nëpërmjet hartimit të dokumentit politik me mbështetjen e Bankës Botërore.
- Miratimi i modelit RIA dhe testimi i tij në tre fusha pilot, inspektim, bujqësi dhe mjedis.
- Trajnimi i punonjësve të ministrive të linjës në dy faza në kuadër të RIA-s.

4.5 MBËSHTETJE PËR MBIQYRJEN E TREGUT, INFRASTRUKTURËN E CILËSISË DHE PRONËSISË INDUSTRIALE

Inspektoriati Qendror Teknik

Objektivat e politikës

- Fuqizimi i kapaciteteve ekzistuese të strukturës së inspektimit dhe mbikqyrjes së tregut.
- Pasurimi i laboratorëve testues përkundrejt cilësisë dhe testimit të pajisjeve
- Certifikimi i personelit inspektues dhe kampionmarrës dhe vazhdimi i procedurave të akreditimit të dy laboratorëve ekzistues në IQT.

Produktet që do të ofrohen:

- Ngritja e kapaciteteve ekzistuese dhe plotësimi i kushteve teknike dhe njerëzore në shkallën e nevojave që ka IQT për të realizuar në nivelin e objektivave të caktuara për detyrën e inspektimit dhe të mbikqyrjes së tregut të produkteve jo ushqimorë.
- Plotësimi i kuadrit ligjor në të dyja fushat me qëllim rritjen e kapaciteteve, të performancës dhe të efikasitetit të veprimtarisë inspektuese dhe mbikqyrëse të IQT
- Zgjerimi i hapësirës së mbikqyrjes së tregut të produkteve jo ushqimorë në dogana dhe në zonat më tregtare të vëndit
- Rritja e shkallës së identifikimit të produkteve jo ushqimorë industriale që nuk përputhen me konformitetin dhe sigurinë e tyre
- Kompletimi i mëtejshëm i IQT me pajisje dhe aparatura laboratorike për të siguruar testimin e të gjithë treguesve të cilësisë së produkteve të naftës e të gazit, të testimit onsite me laboratorë mobile si edhe të produkteve jo ushqimorë
- Plotësimi i kushteve për sigurimin e akreditimit të laboratorëve e të personelit të vet
- Sigurimi i një database të plotë të të dhënave të inspektimit kontrollit dhe të mbikqyrjes së tregut në të gjithë vëndin
- Sigurimi i një rrjeti të plotë informacioni brënda dhe jashtë vëndit për problemet e cilësisë së produkteve të naftës e ata jo ushqimorë si edhe të sigurisë së tregut dhe të produkteve që tregtohen.
- Sigurimi i informacioneve dhe vendosja e lidhjes së bashkëpunimit me laboratorë brënda dhe jashtë vëndit për testimin e produkteve të naftës të kontestuar dhe të produkteve jo ushqimorë

Akreditimi

Objektivat e politikës

- Vlerësimi i DPA nga OEA me qëllim nënshkrimin e marrëveshjes së njohjes dypalëshe me EA si dhe rritja e kredibilitetit të DPA-se në EA, ILAC, IAF

nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në gjithë aktivitetet e organizuara nga këto organizata

Produktet që do të ofrohen:

- Vlerësime dhe mbikqyrje të realizuara në përputhje me standardet përkatëse dhe rishikimi i manaxhimit
- Nënshkrimi i marrëveshjes së njohjes reciproke të akreditimeve për laboratorët testues me EA
- Promovimi i DA nëpërmjet pjesëmarrjes në asambljetë dhe komitetet teknike të EA, ILAC dhe IAF

Metrologjia

Objektivat e politikës

- Implementimi i direktivave të New Approach për metrologjinë (MID dhe NAWI)
- Përgatitja për aplikim për anëtarësim të plotë në EURAMET dhe pjesëmarrja në strukturat rajonale dhe ndërkombëtare të metrologjisë (OIML, WELMEC, EURAMET)
- Realizimi i transmetueshmërisë së matjeve nëpërmjet kalibrimit të etalonëve referencë të DPM

Produktet që do të ofrohen:

- Ndërtimi i Qendrës Kombëtare të Metrologjisë.
- Miratimi i dy projekt VKM -ve që adoptojnë përkatësisht direktivat e Përafrimit të Ri për metrologjinë MID dhe NAWI.
- Qendra Rajonale Lezhë plotësisht funksionale.
- Struktura e dhe organika e DPM e miratuar e DPM “Për organizimin dhe funksionimin e DPM”.
- Përfaqësim dhe pjesëmarrje në Komitetet teknike të 2 organizatave Evropiane (EURAMET dhe WELMEC) dhe 2 organizata ndërkombëtare (OIML dhe BIPM)
- Kalibrimi i standardeve (etaloneve) referencë të matjeve të 8 laboratorëve të DPM
- Rritja e shërbimeve të kalibrimit dhe verifikimi të instrumenteve matës me 2%.
- Pjesëmarrje në 2 ndërkrahime laboratorike në nivel rajonal për vitin 2010

Standartizimi

Objektivat e politikës

- Arritja e 95% e standarteve evropiane të adoptuara si standarte shqiptare

Produktet që do të ofrohen:

- Anëtarësimi me statusin associate në Organizatën Ndërkombëtare të Standardeve IEC
- Standarde evropiane të adoptuara si standarte shqiptare
- Standarde të përkthyer
- Anëtarësimi në komitete teknike

Marka-Patenta

Objektivat e politikës

- Zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit në fushën e pronësisë industriale dhe në administrimin e marreveshjeve ndërkombëtare

Produktet që do të ofrohen:

- Ratifikimi i Konventës Europiane të Patentave - EPC 2000,
- Ratifikimi i marreveshjes për ligjin e patentave me WIPO

4.6 MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

Objektivat e politikës

- Hartimi i një kuadri politik për infrastrukturën institucionale që do të duhet të menaxhojë dhe zbatojë politikën rajonale të Shqipërisë dhe atë të BE.
- Hartimi i Projekt-ligjit “Për Zhvillimin Rajonal në RSH”.
- Ngritja e Drejtorisë së Zhvillimit Rajonal në METE dhe fuqizimi i kapaciteteve të saj.

Produktet që do të ofrohen:

- Dokumenti i kuadrit politik për rishikimin e infrastrukturës institucionale të Zhvillimit Rajonal tëparashikuar në SNZHR, që do të duhet të menaxhojë dhe zbatojë fondet e IPA të harmonizuara me fondet e Buxhetit të Shtetit, i miratuar nga METE, MB, MIE, MF, MPPTT, MMPAU dhe Këshilli i Ministrave.
- Projekt-ligji “Për Zhvillimin Rajonal në RSH”, i përfunduar dhe miratuar në Këshillin e Ministrave.
- Drejtoria e Zhvillimit Rajonal në METE, e ngritur dhe e organizuar, e gatëshme për të përfituar kualifikime dhe forcim të kapaciteteve të saj.

Tabela: Buxheti 2010 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve (në mln/leke)

<i>Programet</i>	<i>Pagat de kontributi i sigurimeve shoqërore 600,601</i>	<i>Mallra dhe Shërbime 602</i>	<i>Subvencionet 603</i>	<i>Të tjera transfert a korrente 604,605</i>	<i>Transfert a për Buxhetet Familjare dhe Individet 606</i>	<i>Shpenzime kapitale 230,213</i>	<i>Totali</i>
Planifikim Menaxhim administrim	207.5	86.8	0.0	10.0	1.2	58.0	363.5
Mbështetje për energjinë	0	1.0	0.0	0.0	0.0	612.0	613.0
Mbësht. për burimet natyrore	157	35.0	0.0	0.0	0.0	590.0	782.0
Mbështetje për zhvillim ekonomik	149.5	88.0	0.0	43.0	0.0	752.0	1,032.5
Mbështe.Mbikq.Tr eg.Infrs.Cil.Pron.Indust.	234	52.0	0.0	7.0	0.0	139.0	432.0
Mbështetje për zhvillim rajonal	0	8.0	0.0	0.0	0.0	225.0	233.0
Total	748	270.8	0.0	60.0	1.2	2,376.0	3,456.0

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2010.

Aneks 1	Treguesit	Aneks 2 a	Njësi Aneks 3 r.
Programi: Planifikim, Menaxhim, Administrim			
1. Përgatitja e Dokumenteve Strategjike në kuadër të zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar		Dokumenti i PIM 2010	
2. Përgatitja e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesem		Dokumenti i prioriteteve 2011-2013	1
3. Raporti vjetor dhe raportet 3-mujore për Vlerësimin dhe Monitorimin e zbatimit të PBA		Dokumenti i PBA 2011-2013	1
4. Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore të zbatimit të PKZMSA.		Raporte vlerësimi dhe monitorimi Raporte monitorimi	12
Programi: Mbështetje për energjinë			
5. Përditësimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë, 2010-2025; përgatitja e Bilancit Energjetik vjetor për vitin 2009; Përgatitja e kuadrit nënligjor për sektorin e gazit natyror, Përgatitja e projektligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike, Përgatitja e projektligjeve , kuadrit nënligjor dhe rregullator për energjitë e rinovueshme dhe për eficientë të energjisë;		Ligje VKM	3 6
